



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:084754

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05846386

KP.nr. 104/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit “Birra Peja” Sh.A., me NUI:811277939, me seli në Pejë, Rruga “Nexhdet Basha” nr.160, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit “Arifaj & Partner’s laë Firm” L.L.C., me Avokat Qendrim Arifaj me seli në Prishtinë Rr.”Tring Smajli”, H 10, nr.6, kundër të paditurit “Infrakos” Sh.A., me NUI:811415620, me seli në Fushë Kosovë, “Sheshi i Lirisë”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Ruzhdi Morina, me objekt kontesti e drejta e kalimit dhe kompensimi i dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më datën 13.06.2024, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datën 21.06.2024 mori këtë :

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditësit “Birra Peja” Sh.A., ashtu që vërtetohet se paditësi me mjete të transportit ka të drejtën e kalimit në vendkalimin në kilometrin 80+010 të hekurudhës Fushë Kosovë – Pejë, ne favor te ngastrave kadastrale me nr. 4616-0 dhe 4617-1 në pronësi te Birra Peja Sh.A, përmes ngastrës kadastrale me numër 5760-1, me kulture infrastrukture ne pronësi te Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës, "Infra kos" Sh. A, ZK Pejë, me dimensione, në gjatësi prej 13.15m ne distance nga binaret prej 3,5m ne perëndim dhe 3,54 m n ne pjesën veriore ne drejtim te fabrikës Birra Peja, ne largësi prej 4.59m nga binarët në gjatësi prej 13.76m.

OBLIGOHEN Paditësi dhe i Padituri që për shfrytëzimin e vendkalimit si në pikën I të këtij vendimi, për sigurinë e komunikacionit hekurudhor dhe rrugorë ti përmbushin të gjitha kushtet teknike të përcaktuara në pëlqimin e të paditurës numër 144 të datës 22.02.2019

OBLIGOHET e paditura "Infrakos" Sh.A qe paditësit "Birra Peja" Sh.A., ne emër te demit te shkaktuar për shkak te rritjes se kostos se shpenzimeve te naftës për moslejimin e shfrytëzimit të drejtës se kalimit te ia paguaj për 42 muaj shumen e përgjithshme prej 108,133.20 €, me kamate ligjore prej 8% nga data marrjes së këtij Aktgjykimi 19.06.2024 e deri ne pagesën definitive.

DETYROHET i padituri që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 6,057,90 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi "Birra Peja" Sh.A., me seli në Pejë, përmes të autorizuarit të tij, me datën 20.07.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurit "Infrakos" Sh.A., me NUI:811415620, me seli në Prishtinë, në të cilën ka theksuar se paditësi ka kërkuar të sigurojë të drejtën e kalimit në rrugën magjistrale Pejë – Fushë Kosovë për t'u kyçur në një linjë hekurudhore, e cila është miratuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – Kuvendi Komunal në Pejë më 27.12.2018. Paditësi ka kryer pagesat dhe ka marrë pëlqimin paraprak për kyçje më 22.02.2019 dhe ka përfunduar punimet për vendkalimin më 03.07.2019. Megjithatë, pala e paditur "Infrakos SHA" ka kërkuar largimin e laurës së sigurisë vendkalimi, duke pretenduar se pëlqimi ishte i përkohshëm. Ka shtuar se largimi i vendkalimit të sigurisë shkakton rrezik për pjesëmarrësit në trafik dhe se kjo kërkesë shkel detyrimet për sigurinë e trafikut hekurudhor të përcaktuara me ligj. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit dhe të vërtetohet se paditësi ka të drejtën e kalimit të pa penguar në vendkalimin në kilometrin 80+010 të hekurudhës Fushë Kosovë- Pejë, sipas kushteve të parapara në pëlqim, duke detyruar të paditurin që të mos pengoj të paditurin në shfrytëzim dhe ta detyroj që të mos e largoj konstruksionin e sigurisë në vendkalim, deri në ndonjë ndryshim të planit urban komunal.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit, ka mbetur në tërësi pranë padisë për të drejtën e kalimit dhe konsideron se pëlqimi paraprak i dhënë nga i padituri ka qenë i dhënë për një periudhë të pa caktuar ndërkaq afati i përcaktuar prej 1 viti ka të bëjë vetëm me kryerjen e punëve investuese përkatësisht ndërtimore të cilat janë kryer nga paditësi dhe e paditura me datë 03.07.2019. Ka theksuar se pëlqimi paraprak i dhënë më

22.02.2019, për ndërtimin e vendkalimit hekurudhor është ende i vlefshëm dhe se paditësi ka ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për përmbushjen e tij. Paditësi theksoi se ka respektuar të gjitha kushtet e pëlqimit paraprak dhe ka paguar shumën prej 2,342.00 euro për montimin e vendkalimit. Me parashtresën e dorëzuar në seancën e datës 13.06.2024, ka bërë precizimin e padisë në aspektin objektiv, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi padia e paditësit me kërkesën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ka shtuar se kërkesa për largimin e laurës së sigurisë dhe për shfuqizimin e pëlqimit është e pabazuar dhe shkel detyrimet ligjore për sigurinë e trafikut hekurudhor dhe se vendkalimi i ndërtuar është në përputhje me të gjitha standardet e sigurisë dhe rregulloret urbanistike, duke përmendur dokumentet e lëshuara nga Komuna e Pejës më 28.12.2018 dhe nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Gjithashtu theksoi se ndërtimi i vendkalimit ka përmirësuar ndjeshëm qasjen në fabrikë dhe ka lehtësuar lëvizjen e banorëve të zonës e largimi i vendkalimit, sipas paditësit, do të rrezikonte sigurinë dhe efikasitetin e trafikut, duke krijuar vështirësi të mëdha për hyrjen e kamionëve dhe përdorimin e rrugës nga banorët. Pos tjerash ka theksuar se duke u bazuar në të lartcekurat dhe në provat e administruara i ka propozuar gjykatës ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si në precizimin e dorëzuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Në përgjigje në padi ashtu edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurit ka deklaruar se padinë e paditësit e kundërshton në tërësi e në mënyrë specifike bazën e padisë. Ndër të tjerash ka theksuar se nuk kuptohet se në çfarë baze dhe në të drejtë kërkon ti njihet dhe ti vazhdohet e drejta e kalimit të pa penguar mbi infrastrukturën hekurudhore duke u thirrur në një pëlqim të lëshuar përkohësisht nr.144, që brenda një viti të bëjë ndërtimin e vendkalimit sipas kushteve të lëshuara në këtë pëlqim. Ka shtuar se çështja e vendkalimeve hekurudhore të përhershme nuk është çështje e vullnetit të paditurit sikur se nuk mund të jetë çështje e vullnetit apo nevojave të paditësit, çështja e vendkalimeve hekurudhore është e përcaktuar me rregulloren 322 e aplikueshme për hekurudhat sa i përket hapjes së vendkalimeve, kjo rregullore është një rregullore teknike që është e aplikueshme në hekurudha për deri sa nuk do të ketë një rregullore tjetër të nxjerrë nga autoriteti rregullator i Hekurudhave, neni 9 i kësaj rregullore përcakton kushtet dhe distancat që duhet të ketë një vendkalim nga një tjetër vendkalim legal e që në rastin konkret nuk janë të zbatueshme për shkak se kërkesa për hapjen e vendkalimit është shumë më afër me vendkalimin ekzistues se sa distancat që janë të përcaktuara me këtë rregullore. Ka theksuar se i padituri në tërësi ka respektuar pëlqimin e

përkohshëm nr.144, datës 22.02.2019, që ia kishte dhënë paditësit si pëlqim të përkohshëm, dhe ky aspekt i përkohshëm ishte elaboruar si në përmbajtjen e pëlqimit ashtu edhe në titullin e tij, pra paditësi e ka pasur të qartë se behet fjalë për një kalim të përkohshëm, sa i përket referimeve se mund të ketë vendkalime tjera në distanca më të afërta se sa ajo që është e lejuar sigurisht se ka, por të njëjtat janë ilegale dhe nuk kane pëlqimet e të paditurit. Ekspertizën e gjeodezisë, komunikacionit dhe ekspertizën nga lëmi financiar i ka kundërshtuar. Sa i përket pretendimeve për dëmet e shkaktuara për demolimin e vendkalimit e ka konstatuar në tërësi, kjo për faktin se i padituri ka përgjegjësi ligjore në bazë të ligjit mbi hekurudhat dhe rregullave tjera teknike që të ofroj komunikacion të sigurt. I ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar dhe të pa lejuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave dhe atë : ekspertizës së gjeodezisë të punuar nga eksperti Bleron Bardhi e pranuar në gjykatë me datë 26.06.2023; ekspertizës së komunikacionit të punuar nga eksperti B.L. dhe G.K. e datës 20.11.2023; ekspertizës financiare e punuar nga eksperti U.B., e dorëzuar në gjykatë me datë 18.12.2023; Njoftimi paraprak nga Drejtorati për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit- Kuvendi Komunal Pejë, datë 28.12.2018; Pëlqimi paraprak i të paditurës, numër 144, datës 22.02.2019; Njoftimi nga Infracos, i datës 03.07.2019; Elaborati i ndërtimit të konstruksionit të vendkalimit në nivel hekurudhor KM.80+ 010 me shina të tipit S49; Specifikacioni i shpenzimeve të paditurës; shqimi në fotografitë e vendkalimit; komunikimi elektronik i datës 18.05.2020; komunikimi elektronik, i datës 10.07.2020 i paditëses me kërkesën për rishqyrtim të kërkesës për demontimin e konstruksionit të sigurisë; kërkesa për demontimin e vendkalimit ilegal, numër 423, datës 16.06.2020, përpiluar nga e paditura drejtuar paditësit; Vendimi, numër 390, datës 03.06.2020, përpiluar nga Infracos, për themelimin e këtij komisioni për evidentimin dhe trajtimin e vendkalimeve ilegale dhe ndërhyrjen në pronë të Infracosit; komunikimet elektronik në mes të paditurës dhe paditësit të datës 27.05.2020, 08.07.2020, 10.07.2020,13.07.2020, 14.07.2020, 07.07.2020; shikimi në fotografitë; Kërkesa për ndërprerjen e punimeve dhe largimin e rrethojës nga prona e Infracosit, datës , me numër 506, 05.08.2016; Informata-fletëparaqitja, përpiluar nga e paditura drejtuar policisë së Kosovës, me nr. Protokollit 810, datës 01.12.2019; Raporti, datës 20.09.2017, përpiluar nga e paditura; Procesverbali për kontrollimin e pronës se Infracosit në teren, datës 18.09.2017; Certifikata P-71611071-05760-1,

datës 09.09.2020; parashtrësës me titull kërkesë e datës 19.09.2020, drejtuar nga paditësi tek e paditura; procesverbali i hapjes se tenderit, nga Infracos, datës 06.11.2023.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga leximi i ekspertizës së gjeodezisë të punuar nga eksperti Bleron Bardhi e pranuar në gjykatë me datë 26.06.2023, në raportin e tij eksperti ka konstatuar se në ngastrën me numër 5760-1 e cila është në pronësi të paditurit është ndërtuar Laura e cila mbahet në dy pika, nga pika 1 deri 2 dhe e cila ka gjatësi prej 13.15m dhe gjendet në distancë nga binarët e trenit 3.56m dhe 3.54 m. Pas kalimit të binarëve të trenit në distancë prej 4.59 m nga binarët gjendet porta nga metali (dera rrëshqitëse) e cila shtrihet në drejtim lindje-perëndim e paraqitur në skicë ndërmjet pikave 3 dhe 4 e cila ka hapje në gjatësi prej 13.76 m, në të dy anët e portës në drejtimet lindje perëndim shtrihet rrethoja nga metali. Në pjesën veriore prapa portës hyrëse gjendet një kioskë nga metali me etazhitet P+0 e cila shërben për qëndrim të personelit të sigurimit dhe e cila ka dimensione 3m x 3m dhe është paraqitur në skicë me ngjyrë të kuqe. Nga rruga magjistrale Pejë-Prishtinë në drejtim të laurës dhe portës hyrëse është pjesë e asfaltuar ku në të dy anët e rrugës shtrihet trotuari nga kubzat e betonit, ndërsa pjesa nga laura në drejtim të binarëve të trenit është asfalt i dëmtuar si dhe pjesa nga binarët në drejtim të portës hyrëse është asfalt i dëmtuar.

Nga leximi i ekspertizës së komunikacionit të punuar nga eksperti B.L. Ekspert i komunikacionit dhe G.K. Ekspert i komunikacionit hekurdhur e datës 20.11.2023, në raportin e tyre ekspertët kanë konstatuar se vendkalimi i ndërtuar nga paditësi është ndërtuar në bazë të akteve juridike në fuqi për sigurinë hekurudhore dhe rrugore, përjashtimisht distanca nga vendkalimi më i afërt i cili nuk e plotëson kriterin teknik të distancës në mes të vendkalimeve të njëpasnjëshme. Në aspektin e ofrimit të sigurisë për pjesëmarrësit në komunikacion ofron siguri më të madhe krahasuar me vendkalimet tjera, pasi që i njëjti është i pajisur me sinjalizim adekuat, mbrojtës dhe gjysmëmbrojtës dhe kabinë për operator të vendkalimit. Vendkalimi kryqëzohet me linjën hekurudhore Pejë – Prishtinë dhe duke u bazuar në orarin e lëvizjes së trenave të udhëtarëve konstatojmë se ky vendkalim për momentin nuk paraqet pengesë të theksuar për lëvizjen e trenave. Numri total i vendkalimeve në linjën Pejë – Prishtinë bazuar në të dhënat e marra nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është gjithsej 97 vendkalime, ku prej tyre 83 janë vendkalime të legalizuara dhe 14 vendkalime ilegale. Ka konstatuar se i vetmi kusht i pa

plotësuar bazuar në rregulloren 322 është kushti teknik mbi distancën minimale (700 metra) në mes të vendkalimeve Birra Peja dhe tek Dogana, ndërsa kushtet tjera nga aspekti teknik mbi sigurinë e pjesëmarrësve në këtë vendkalim janë plotësuar.

Nga leximi i ekspertizës financiare të punuar nga eksperti U.B., e dorëzuar në gjykatë me datë 18.12.2023, eksperti në raportin e tij ka konstatuar koston e karburantit dhe normën efektive të punës e cila është shkaktuar si rezultat i shfrytëzimit të rrugëve alternative në vend të asaj me qasje direkte në segmentin rrugor Pejë-Prishtinë apo siç është e njohur si rruga M9. Kostoja e kompanisë është afërsisht 117.03 euro në baza ditore, 585.14 në baza javore dhe rreth 2,574.60 euro në baza mujore. Kostoja apo humbja e përgjithshme vjetore është 30,895.20 euro, që shkaktohen potencialisht si humbje për biznes për 2.5+2.5 km rrugë. Sikurse e drejta të realizohej sipas kërkesës së paditësit atëherë biznesi nuk do të dëmtohej në masë siç është paraqitur në këtë ekspertizë.

Nga leximi i Njoftimit paraprak nga Drejtorati për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit-Kuvendi Komunal Pejë, i datës 28.12.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se sipas kërkesës për pëlqim për kyçje në rrugë DUUM e ka njoftuar se sipas PRRU “Kristali” të miratuar me nr.01-350-7063 të datës 27.09.2011, nuk ka pengesa për qasje pasi që sipas planit është paraparë rrugë.

Nga leximi i pëlqimit paraprak i të paditurit, numër 144, datës 22.02.2019, është vërtetuar fakti se i padituri duke u bazuar në pëlqimin e lëshuar me datë 28.12.2018, ka dhënë pëlqimin e përkohshëm paditësit për hapjen e vendkalimit në km 80+010 të linjës së hekurudhës Pejë – fushë Kosovë, dhe janë përcaktuar edhe kushtet e sigurisë së komunikacionit për shfrytëzimin e këtij vendkalimi.

Nga leximi i Elaboratit të ndërtimit të konstrukcionit të vendkalimit në nivel hekurudhor KM.80+ 010, gjykata ka konstatuar faktin se punimet për shfrytëzimin e këtij vendkalimi i ka punuar vetë e paditura me çrrastë edhe e ka faturuar paditësen për obligimin të cilin ajo duhet ti përmbush me pasi që e paditura ka bërë rregullimin vendkalimit.

Nga leximi i njoftimit nga Infracos, i datës 03.07.2019, është vërtetuar fakti se i njëjti i është drejtuar Departamentit të Financave duke e njoftuar se sipas Pëlqimit nr.144 të datës 22.02.2019, për hapjen e vendkalimit në nivel për nevoja të “Birra Peja” janë realizuar punimet në ndërtimin dhe rregullimin e vendkalimit.

Nga leximi i Specifikacionit të shpenzimeve të paditurit, është vërtetuar fakti se për rregullimin e vendkalimit për nevoja të Birra Peja është faturuar shuma e përgjithshme prej 2,342.30 euro.

Nga shqimi në fotografitë e vendkalimit, është vërtetuar fakti se është paraqitur montimi i konstruksionit të vendkalimit në nivel me hekurudhën.

Nga leximi i komunikimit elektronik të datës 18.05.2020, është vërtetuar fakti se i padituri i është drejtuar paditësit duke e njoftuar se ka kaluar afati kohor prej një viti dhe i ka kërkuar që të respektohet në përpikëri pëlqimi nr.144 i datës 22.02.2019, si dhe duke kërkuar që të njoftohet për çdo veprim të ndërmarrur për demontimin e vendkalimit në mënyrë që të mos vije deri te rrezikimi i komunikacionit hekurudhor.

Nga leximi i komunikimit elektronik, i datës 10.07.2020, është vërtetuar fakti se paditësi i është drejtuar të paditurit me kërkesën për rishqyrtim të kërkesës për demontimin e konstruksionit të sigurisë.

Nga leximi i kërkesës për demontimit e vendkalimit ilegal, numër 423, datës 16.06.2020, përpiluar nga i padituri drejtuar paditësit, është vërtetuar fakti se është kërkuar nga paditësi që të bëjë demontimin e menjëhershëm të vendkalimit dhe ta kthej gjendje paraprake në mënyrë që të mos rrezikohet komunikacioni hekurudhor, duke kërkuar që demontimi të bëhet më së largu brenda afatit prej 30 ditësh në të kundërtën do të shfrytëzohen të gjitha masat ligjore.

Nga leximi i Vendimit me numër 390 i datës 03.06.2020, është vërtetuar fakti se i padituri ka themeluar komisionin për evidentimin dhe trajtimin e vendkalimeve ilegale dhe ndërhyrjen në pronë të Infrakosit.

Nga leximi i komunikimeve elektronike në mes të paditurit dhe paditësit të datës 27.05.2020, 08.07.2020, 10.07.2020,13.07.2020, 14.07.2020, 07.07.2020, është vërtetuar fakti se të njëjtit kanë komunikuar lidhur me zbatimin e kërkesës për demontim dhe se për shkak të situatës së krijuar kanë komunikuar për caktimin e një takimi sqarues.

Nga leximi i Kërkesës për ndërprerjen e punimeve dhe largimin e rrethojës nga prona e Infrakosit, datës , me numër 506, 05.08.2016, është vërtetuar fakti se i padituri i është drejtuar paditësit për ndërprerjen urgjente të punimeve dhe largimin e rrethojës nga prona e të paditurit dhe kthimin e pronës në gjendjen e mëparshme.

Nga leximi i Informatës-fletëparaqitjes, përpiluar nga i padituri drejtuar Policisë së Kosovës, me nr. Protokollit 810, datës 01.12.2019, është vërtetuar fakti se i padituri ka paraqitur rastin në polici duke kërkuar që të veprojnë menjëherë në mënyrë që të bëjë mbrojtjen e pronës dhe identifikimin e kryesit të kësaj vepre penale- ndërmarrjen e angazhuar për kryerjen e punëve apo personave.

Nga leximi raportit të datës 20.09.2017, përpiluar nga i padituri, është vërtetuar fakti se i njëjti ka përpiluar një raport lidhur me veprimet e marra pas njoftimit se ka ndërhyrje në km 80+00 në Komunën e Pejës.

Nga leximi i procesverbalit për kontrollimin e pronës se Infrakosit në teren, datës 18.09.2017, është vërtetuar fakti se i padituri ka dalur në teren, në proces kanë konstatuar lidhur me zhvillimin e punimeve.

Nga leximi i Certifikatës P-71611071-05760-1, datës 09.09.2020, vërtetohet fakti se ngastra kadastrale evidentohet në emër të paditurit, më gjerësisht sikurse në certifikatën pronësore.

Nga leximi i parashtresës me titull kërkesë e datës 19.09.2020, drejtura nga paditësi tek i padituri, është vërtetuar fakti se paditësi ka kërkuar që të rishqyrtohet vendimi të paditurit në lidhje me vendkalimin objekt kontesti.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura gjeti se kërkesepadia e paditësit është e bazuar dhe atë për shkaqet si në vijim:

Nga deklarimet e palëve ndërgjyqëse dhe nga elaborimi i provave të sipër cekura për asnjërën nga palët nuk është kontestues fakti se paditësi është pronarë i ngastrave kadastrale nr. 4616-0 dhe 4617-1 ZK Pejë, si dhe i padituri është pronarë i ngastrës kadastrale 5760-1 ZK Pejë, ndashtu nuk është kontestues fakti se paditësi ka ushtruar kërkesë tek e paditura për hapjen e vendkalimit në aksin Fushë Kosovë – Pejë Km 80-010, si dhe dhënia e pëlqimit nga ana e të paditurës për hapjen e vendkalimit në këtë akse si dhe përcaktimi i kushteve të sigurisë së komunikacionit hekurudhor dhe komunikacionit rrugorë për hapjen e këtij vendkalimi, gjithashtu nuk ishte kontestuese se e paditura i ka përmbushur që gjitha obligimet në raport me paditësin për hapjen e këtij vendkalimi pasi që e paditura i ka realizuar punimet dhe mundësimin e hapjes së këtij vendkalimi me standardet e përcaktuara nga vetë e paditura, nuk ishte kontestuese se paditësi e ka përmbushur pagesën e kërkuar nga e paditura, Gjithashtu nuk është

kontestuese se pas kalimit të afatit 1 vjeçar e paditura ka kërkuar nga paditësi që të respektohet afati i caktuar dhe të demolohet vendkalimi, si dhe fakti se asfalti i shtruar në vend kalim është larguar nga ana e të paditurës dhe është pamundësuar shfrytëzimi i mëtejshëm i këtij vendkalimi.

Në rastin konkretë kontestues në mes të palëve ishte se pëlqimi për hapjen e vendkalimit në aksin Pejë – Fushë Kosovë km 80-010, a ishte me karakter të afatit të përcaktuar 1 vjeçar për realizimin e punimeve apo shfrytëzimin e këtij vendkalimi për periudhën 1 vjeçare, si dhe periudha kohore e dhënies së pëlqimit për hapjen e këtij vendkalimi.

Në këtë çështje juridike – kontestimore gjykata gjeti zbatim në dispozitat e Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore (LPTDS i cili ligj ka hyrë në fuqi më datën 20.08.2009)

Gjykata ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit sa i përket të drejtës së kalimit duke marr për bazë gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë e mbështetur në dispozitat ligjore dhe atë sipas nenit 252 përcaktohet se *“1. Servituti sendor është e drejta e pronarit përkatës të një paluajtshmërie (paluajtshmëria dominuese) që një paluajtshmëri tjetër (paluajtshmëria shërbyese) në një mënyrë të caktuar ta shfrytëzojë apo të ndaloj kryerjen e veprimi të caktuar ose të përjashtoj ushtrimin e së drejtës së caktuar, të cila rrjedhin nga e drejta e pronësisë në paluajtshmerinë shërbyese.. Ndërsa neni 253 përcakton se krijimi i servitutit sendor dhe atë: “1. Servituti sendor krijohet në bazë të një punë juridike, një vendimi të organit shtetëror ose një ligji. 2. Për krijimin e një servituti sendor sipas punës juridike është e nevojshme një kontratë dhe regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeritë. Me kontratë palët duhet të merren vesh, për krijimin dhe përmbajtjen e servitutit. 3. Dispozitat në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni do të zbatohen në të gjitha rastet përveç nëse me vendim administrativ ose me ligj të veçant parashihet ndryshe”.*

Gjykata duke u nisur nga fakti se palët në procedurë jashtë gjyqësore në vitin 2019 kanë zhvilluar procedurë administrative të përcaktuar sipas rregulloreve të paditurës, me ç’rast paditësi ka ushtruar kërkesë ndërsa i padituri i është përgjigjur kërkesë së paditësit duke i dhënë pëlqim me karakter të përkohshëm për hapjen e vendkalimit në km 80+010 duke i përcaktuar kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit, pos kushteve për mënyrën e shfrytëzimit ka përcaktuar edhe kushtet teknike për sigurinë e komunikacionit rrugor dhe hekurudhor, e të cilat kushte vetë i padituri i ka implementuar dhe përmbushur në interes të kërkuarit tani paditësit, ku pas përmbushjes së këtyre kushteve ka faturuar kërkuarin këtu paditësin për përmbushjen e obligimit financiar, e të cilat obligime janë përmbushur nga ana e paditësit.

Gjykata fillimisht vlerësoj pëlqimin me numër 144 të datës 22.02.2019 të lëshuar nga ana e të paditurës dhe pretendimeve të paditësit se ky pëlqim është lëshuar me afate 1 vjeçar për kryerjen e punimeve për hapjen e vendkalimit si dhe deklarimin e të paditurës se ky pëlqim është lëshuar me karakter të përkohshëm të shfrytëzimit të këtij vendkalimi për periudhën 1 vjeçare, andaj për gjykatën në pëlqimin e sipër cekur është aprovuar kërkesa e paditësit dhe është dhënë pëlqimi i përkohshëm në afate prej një viti sipas pikën 1 të këtij vendimi ndërsa lidhur me pikën 14 po të njëjtë vendim afati prej 1 viti është dhënë për kryerjen e punëve të parapara nga investuesi në këtë rast paditësit, pasi që nëse kalon ky afat prej 1 viti i njëjti obligohet që të përsërisë kërkesën, andaj në as një pikë nuk është përcaktuar periudha e shfrytëzimit të vendkalimit, edhe nga vetë titulli i shkresës Pëlqim paraprak për hapjen e vendkalimit nivel i cili do të jetë i përkohshëm në km 80+010 të linjës së hekurudhës Prishtinë – Fushë Kosovë, përcaktohet se pëlqimi nuk është i përhershëm por i përkohshëm por pa u specifikuar periudha e shfrytëzimit të vendkalimit, afati prej 1 viti ishte përcaktuar vetëm për përfundimin e punimeve për shfrytëzimin vendkalimit, andaj gjykata pas vlerësimit të të njëjtës meqenëse një herë janë plotësuar kushtet për dhënien e pëlqimit për hapjen e vendkalimit nga vetë e paditura, vlerësoi se në rastin konkret vendkalimi apo servituti është konstituar andaj edhe vendosi që të aprovoj kërkesëpadinë.

Gjykata nisur nga ky fakt dhe vlerësimit të ekspertizës së komunikacionit rrugor – hekurudhor ku në konstatimet e tyre në ekspertizë dhe elaborimit të njëjtës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, pas dhënies së përgjigjeve dhe sqarimeve lidhur me qëndrimin dhe mendimin e tyre profesional se vendkalimi i ndërtuar nga paditësi është ndërtuar në bazë të akteve në fuqi për siguri hekurudhore duke përjashtuar distancën prej 700 metrave në aspektin teknik të cilën nuk e plotëson, por i plotëson të gjitha parametra tjerë në aspektin e ofrimit të sigurisë për pjesëmarrjen në komunikacion, si dhe ky vendkalim nuk ndikon në dëme të paditurës, e posaçërisht faktin se ky vendkalim shkurton kohën dhe koston e mjeteve të transportit për paditësin pasi që përmes këtij vendkalimi qasja është shumë më e lehtë në hyrje dalje me mjete të transportit për paditësin, si dhe këto konstatime janë të mbështetura edhe në ekspertizën financiare të datës 18.12.2023 ku pos tjerash eksperti ka bërë vlerësimin e koston financiare të paditësit në qarkullimin e rrugës ekzistuese në raport me qarkullimin pas hapjes së vendkalimit, e i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në qarkullimin dhe qasjen në rrugë të paditësit, andaj gjykata i ka vlerësuar këto ekspertiza dhe të njëjtave i ka falur besimin e plotë pasi që të njëjtat ishte të punuar në mënyrë profesionale, kanë shtjelluar të gjitha pikat kyçe të vërtetimit të gjendjes së plotë dhe të drejtë faktike.

Nisur nga të cekurat dhe parimi i restriksionit të servitutit nënkupton se ushtrimi i servitutit duhet të bëhet me kujdes në atë mënyrë që titullari i të drejtës së servitutit ta ushtrojë të drejtën e vet, në atë mënyrë që sa ma pak ta ngarkojë apo dëmtojë pasurinë shërbyese. Ky parim gjen mbështetje në dispozitat e nenit 254, të LPDTS-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se: *“1. Titullari i të drejtës së servitutit sendor duhet ta ushtron servitutin në atë mënyrë, që pasurisë së paluajtshme shërbyese ti paraqes ngarkesën më të vogël të mundshme. 2. Gjatë ushtrimit të një servituti, titullari i servitutit i ruan në mënyrë adekuate edhe interesat e pronarit të paluajtshmërisë së ngarkuar, derisa nuk cenohet ushtrimi i servitutit”*, E që në rastin konkret është plotësuar në tërësi pika 1 dhe 2 e kësaj dispozite pasi që paditësi me financa të tije ka ndërtuar dhe mirëmbajtur vendkalimin ndërsa për ndërtimin e të njëjtës duke i plotësuar të gjitha parakushtet e përcaktuara nga e paditura ky vendkalim është ndërtuar nga e paditura fakte i pa kontestueshëm nga palët në procedurë dhe se i njëjti i plotëson të gjitha parametrat e sigurisë së komunikacionit rrugor dhe hekurudhor, e i cili vlerësim ishte determinues në çështjen konkrete, përdorimi i këtij vendkalimi i shërben paditësit si në arsyetimin e më sipërm ndërsa në as një formën nuk është vërtetuar se i shkakton ndonjë lloj dëmi të paditurës.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, duke i obliguar palët në procedurë që për përdorimin e vendkalimit të dyja palët ti përmbushin të gjitha kushtet e përcaktuara në pëlqimin e të paditurës numër 144 të datës 22.02.2019 sa i përket sigurisë së komunikacionit rrugor dhe hekurudhor, pas vlerësimit se e paditura është autoritet i vetëm për menaxhimin e hekurudhave të Kosovë, dhe se e njëjta pas dhënies së pëlqimit dhe vlerësimit të kushteve teknike të sigurisë në komunikacionit duhet ti mundësoj paditëses shfrytëzimin e vendkalimit në km 80+010, ndërsa paditësja duhet ti respektoj të gjitha kushtet e teknike për siguri në komunikacionin rrugorë dhe hekurudhor të përcaktuara nga e paditura në pëlqimin paraprakë.

Ndërsa gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi duke aprovuar kërkesë padinë e paditësit sa i përket kompensimit të dëmit material për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të vendkalimit 80+010, pasi që e paditura në mënyrë arbitrare e ka demoluar pjesën e asfaltit dhe ka pamundësuar vazhdimin përdorimin e këtij vendkalimi, edhe pse e njëjta i kishte lejuar përmes pëlqimit paraprak, hapjen e këtij vendkalimi dhe mundësimin e investimit në gjithë infrastrukturë për realizimin sa më të lehtë të qasjes në rrugë për qarkullim sa më të lehtë dhe të përshtatshëm për të dyja palët.

Nga gjendja faktike e vërtetuar, Gjykata gjen se në rastin konkret, për kërkesat që kanë të bëjnë me dëmet për shkak të pamundësisë së përdorimit të vendkalimit gjejnë zbatim dispozitat

e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077) si ligj i aplikueshëm në kohën e krijimit të raportit juridik-detyrimor.

Me nenin 136 të LMD-së përcaktohet se “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Me Nenin 137 është definuar se “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).*”

Me Nenin 169 të LMD-së përcaktohet se “*1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla.*”

Për vlerësimi e lartësisë së kompensimit, Gjykata e mori për bazë ekspertizën financiare të punuar nga eksperti U.B., eksperti sipas parametrave të marra si bazë ka llogaritur koston e shpenzimeve të derivateve të mjeteve motorike të paditësin dhe distancën e rrugës të cilën e kanë përshkruar këto mjete motorike pas ndalimit të shfrytëzimit të vendkalimit i cili paditësit i kishte shkaktuar dëme material.

Vlerësimi të ekspertit, Gjykata i fali besimin në tërësi, Gjykata vlerësoi se ekspertiza është punuar në mënyrë profesionale, i cili ka marrë për bazë mjetet motorike transportuese të paditësit të cilit kanë qarkulluar rregullisht distancën e udhëtimit për periudhën sa ishte vendkalimi i hapur dhe pas mbylljes së vendkalimit, dhe me atë raste ka llogaritur kilometrat shtesë, të distancën së udhëtimit, koston e rrugëve transportit në litër derivate, normën efektive të kohës së punës së punëtorëve dhe ka mbledhur në tërësi koston e dëmit material që i është shkaktuar paditësit.

Gjykata me rastin e vendosjes mori për bazë edhe të gjitha kundërshtimet e palës së paditur, të dhënë në përgjigjeje në padi dhe kundërshtimeve të dhëna gjatë shqyrtimit kryesor, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe.

Për kamatën gjykata ka vendosur, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së, për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë për kompensimin e dëmit andaj kamata është gjykuar në 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, konform dispozitave të LMD-së, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë bazuar në nenin 452 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i palës së paditur, i referohen shumës së precizuar si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi, dhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumën prej 325.00 euro, në emër të përfaqësimit në nëntë seanca (9x422.50 euro) shumën prej 3,802.50 euro, në emër të ekspertizës së gjeodezisë shumën prej 330.40 euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit 1,000.00 euro, në emër të ekspertizës financiare shumën prej 600.00 euro në shumë totale prej 6,057,90 euro, ndërsa refuzoj shumën prej 422,50 euro për seancën e ndërmjetësimit.

Nga arsyet e cekura dhe bazës ligjore të cekur si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.104/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.